

VENDIM
Nr. 187, datë 4.4.2019

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 708, DATË 21.11.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR REGJISTRIMIN DHE KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN TË DISA
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, NË VIJËN BREGDETARE
VLORE–SARANDË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 34 e 41, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 708, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Pronat e paluajtshme sipas pikës 1, që ndodhen në zonat në të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, do të regjistrohen në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit fillestar të pronave private në zonat kadastrale të përfshira në këtë vendim.”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama